



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr. 2014 Prot

Vlorë, më 30 12 2024

VENDIM

Nr. 22, datë 24 12 2024

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË KËSHILLTARIT TË KËSHILLIT TË
QARKUT VLORE ZNJ. NERVIDA LAZAJ

Këshilli i Qarkut Vlorë në mbështetje të Nenit 75, pika 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Selenicë Nr. 42, datë 27.11.2024 "Mbi zgjedhjen e përfaqësuesit të Këshillit të Bashkisë Selenicë në Këshillin e Qarkut",

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënie e mandatit të këshilltarit në Këshillin e Qarkut Vlorë Znj. Nervida Lazaj.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit të Qarkut Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretar i Këshillit të Qarkut

Vllasi Nasaj

Specialist/Jurist

Alma Myrtaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

RELACION

Të Nderuar Këshilltarë!

Pranë institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë është protokolluar me Nr. 1911 Prot, datë 06.12.2024, shkresa e Këshillit të Bashkisë Selenicë Nr. 2487 Prot, datë 04.12.2024, me lëndë "Përcjellje e Vendimit të Këshillit të Bashkisë Selenicë", bashkëlidhur së cilës gjendet dokumentacioni i Këshillit të Bashkisë Selenicë i cili më datë 27.11.2024 ka marrë në shqyrtim zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Bashkisë Selenicë si përfaqësues në Këshillin e Qarkut Vlorë pas dorëheqjes së Z. Sokol Hodaj si anëtar i Këshillit Bashkiak Selenicë.

Në dokumentacionin e dërguar ndodhen:

1. Kërkesa e Këshillit të Bashkisë Selenicë Nr. 2487 Prot, datë 04.12.2024, me lëndë "Përcjellje e Vendimit të Këshillit të Bashkisë Selenicë".
2. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Selenicë Nr.42, datë 27.11.2024 "Për zgjedhjen e anëtarit që do të përfaqësojë Këshillin e Bashkisë Selenicë në Këshillin e Qarkut Vlorë Znj.Nervida Lazaj".

Duke parë se dokumentacioni i dorëzuar nga ana e Këshillit të Bashkisë Selenicë është i plotë, bazuar në Nenin 75, pika 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ju ftojme që të procedojmë me miratimin e këtij vendimi.

Ju falënderoj!

Sekretar i Këshillit të Qarkut

Vllasi Nasir

Specialist/Jurist

Alma Myrtaj